

**SUPREME COURT OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL**  
**KOLEGJI I APELIT TË AKP-së**  
**ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-051/13**

**Prishtinë,**  
10 Dhjetor 2014

Në çështjen juridike të:

**R. S.**

Novobërdë

**Pala ankuese**

Kundër

**P. A.**

Kragujevac  
Serbi

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/92/2010 të datës 28 tetor 2010 (lënda e regjistruar në AKP me numrin nr. 40416), pas seancës gjyqësore të mbajtur më 10 Dhjetor 2014, mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. **Hidhet si e papranueshme ankesa e R. S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/A/92/2010 (për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA40416) të datës 28 tetor 2010, për shkak se ankesa është e paafatshme.**

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 16 gusht 2007 Pala përgjegjëse në ankesë ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon ri-posedim dhe kompensim lidhur me ngastrën nr. 925, Zona Kadastrale Prekocv, me sipërfaqe prej 5 ari dhe 57 m<sup>2</sup> që ndodhet në Reka, Komuna e Novobërdës (tani e tutje: Prona).
2. Në praninë e Palës përgjegjëse në ankesë AKP, me datën 13 dhjetor 2007, kishte bërë verifikimin e lokacionit të pronës dhe kishte vendosur njoftimin në atë tokë.
3. Asnjë Palë përgjegjëse në kërkesë nuk ishte paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive për të kundërshtuar kërkesën para skadimit të afatit prej 30 ditësh.
4. KKPK e kishte miratuar kërkesën dhe kishte lëshuar vendimin KPPC/A/13/2008 të datës 30 prill 2008.
5. Në Rezolutën nr. KPCC/RES/14/2010 të datës 11 shkurt 2010, KKPK kishte cekur se kërkesa nuk ishte proceduar si duhet pasi që prona e kërkuar nuk ishte identifikuar fizikisht dhe njoftimi për të nuk ishte bërë si duhet. Për këtë arsye KKPK kishte vendosur që:
  - Të shfuqizohet vendimi i Komisionit;
  - Kërkesa ti kthehet përsëri Sekretarisë Ekzekutive për procedim të mëtejshëm bazuar në identifikimin e saktë dhe njoftimin e duhur të pronës së kërkuar
  - [...]”.
6. Kërkesa për pronën ishte ri-notifikuar më 22 korrik 2010. Sipas Raportit të Notifikimit dhe të Konfirmimit të datës 22 korrik 2010, kërkesa është notifikuar përmes publikimit në Gazetën nr.5, e cila është lënë në fshat, në disa zyra komunale dhe në Zyrat e UNHCR-së dhe të Ombudspersonit.

7. Ri-notifikimi nuk kishte rezultuar në ndryshim material, për sa i përket kërkesës, sa të ndikonte në vendimin e Komisionit dhe përsëri asnjë Palë përgjegjëse në kërkesë, uzurpues apo ndonjë palë tjetër nuk ishte paraqitur në AKP.
8. Bazuar në notifikimin e ri, KKPK kishte marrë vendimin KPCC/D/A/92/2010 të datës 28 tetor 2010 (tani e tutje: Vendimi i KKPK-së). KKPK vendosi që:
  - Pala përgjegjëse në ankesë ka dëshmuar se ai është pronar me 1/1 i pronës dhe ka të drejtë posedimi mbi të;
  - Pala/palët përgjegjëse në kërkesë, nëse ka, dhe çdo person tjetër që e ka uzurpuar pronën, ta liroj atë brenda 30 ditëve.
9. Vendimi i është dorëzuar Palës përgjegjëse në ankesë me datën 22 qershor 2011.
10. AKP me vendimin e saj të datës 24 nëntor 2011 kishte vendosur ta vendos pronën nën administrim pronësor të AKP-së.
11. Pala ankuese më 25 nëntor 2011 kishte dërguar një letër në AKP. Kjo letër shkruan:
 

*LËNDA: Kërkesë për marrjen e një kopjeje të vendimit të KKPK-së për lëndën KPA40416. Do më nevojitet një kopje e vendimit në mënyrë që të mund të bëjë ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ju falënderoj duke shpresuar se do më plotësohet kërkesa ime brenda afatit sa më të shkurtër në mënyrë që të mos skadojë afati për paraqitjen e ankesës.*
12. AKP kishte pranuar këtë kërkesë me datën 1 dhjetor 2011.
13. Më 13 shkurt 2013 Pala ankuese kishte paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së.
14. Gjykata Supreme e kishte pranuar lëndën më 12 prill 2013.
15. Gjykata Supreme lëshoi një urdhër për Palën ankuese për të deklaruar a) arsyen se pse ai nuk kishte marrë pjesë në procedurën para KKPK-së lidhur me rastin, dhe b) kur dhe si ishte informuar ai lidhur me vendimin e KKPK-së.
16. Në përgjigje ndaj urdhrit të Gjykatës Supreme, Pala ankuese ka deklaruar se herën e parë që ai ishte informuar mbi rastin kishte qenë në mënyrë verbale nga një punëtor i AKP-së në nëntor të vitit 2011. Ai gjithashtu kishte theksuar se ai kishte shkuar në Zyrën Qendrore të AKP-së në Gjilan për të kërkuar informacion lidhur me rastin. Përgjigja e vetme që ai kishte marrë nga AKP-ja ishte se kërkesa ishte publikuar në gazeta dhe se ai ka të drejtë të paraqes një ankesë në Gjykatën Supreme.

### **Pretendimet e palëve**

17. Pala ankuese thekson se KKPK kishte marrë një vendim të gabuar për shkak të mungesës së provave. Ai thekson se ai nuk ishte në dijeni për procesin e kërimit të pronës.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

18. Pala ankuese nuk ishte palë në instancën e pare para KKPK-së.
19. Sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079 (tani e tutje: Ligji UNMIK 2006/50) çdo person i cili aktualisht ushtron apo që pretendon të drejta ndaj pronës e cila është subjekt i kërkesës dhe/ose çdo person tjetër i cili mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar, është palë në kërkesë dhe në procedurat që kanë të bëjnë me të, nëse ky person e informon AKP-në lidhur me qëllimin e tij për të marrë pjesë në procedurën administrative.
20. Sipas nenit 12.1 të Ligjit UNMIK 2006/50, vendimi i KKPK-së mund të ankimohet në KKPK nga pala brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të palëve për vendimin e KKPK-së. Megjithatë, kur Pala ankuese nuk i bashkëngjitet procedurës në KKPK, ankesa është e pranueshme nëse Pala ankuese është në palë e interesuar e cila nuk është njoftuar si duhet për kërkesën dhe nuk ka qenë në dijeni ose në mënyrë të arsyeshme nuk ka mundur të jetë në dijeni për kërkesën para se ai të paraqiste ankesën. Në një situatë të këtillë ai duhet të paraqes ankesën brenda 30 ditëve prej momentit që ai vihet në dijeni mbi vendimin e KKPK-së dhe për mundësinë për të paraqitur ankesën.
21. Pala ankuese thekson se ai është informuar për kërkesën dhe vendimin e KKPK-së në nëntor 2011. Kjo tregon se ai ka marrë dijeni për here te pare per kërkesën pasi KKPK-ka ka vendosur mbi te.
22. Sipas fakteve të përmendura më lartë në paragrafët 5 dhe 6, notifikimi i parë i kërkesës nuk ishte bërë si duhet dhe notifikimi i dytë ishte bërë (vetëm) përmes publikimit në Gazetë. Siç u vendos më herët nga Gjykata Supreme, notifikimi vetëm në Gazetë nuk nënkupton që Pala ankuese është njoftuar në mënyrën e duhur mbi kërkesën dhe që në

mënyrë të arsyeshme ka mundur të jetë në dijeni për kërkesën derisa ajo procedohej në KKPK..

23. Megjithatë, në këtë rast kjo nuk do të thotë se ankesa është e pranueshme. Sipas letrës së tij të datës 25 nëntor 2011 dërguar AKP-së, Pala ankuese, në atë kohë, ishte në dijeni për vendimin e KKPK-së dhe për mundësinë për të paraqitur ankesë por ai nuk kishte paraqitur asnjë ankesë deri me datën 13 shkurt 2013. Rrjedhimisht, ai paraqiti kërkesën pas mbarimit të afatit 30 ditorë siç parashihet me nenin 12.1 të Ligjit UNMIK 2006/50 dhe ankesa duhet të hidhet si e papranueshme.

*Konkluzion*

24. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me dispozitat e nenit 13.3 të Ligjit UNMIK 2006/50 dhe nenin 198 paragrafi 1 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore**

Sipas nenit 13.6 të Ligjit UNMIK 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

**Willem BROUWER, Kryetar i Kolegjit**

**Esmā ERTERZI, Gjyqtar i EULEX-it**

**Sylejman NUREDINI, Gjyqtar**

**Urs NUFER, Referent i EULEX-it**